



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

AKADEMISË SË SHKENCAVE TË SHQIPËRISË (ASHSH)

DHE

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS (UST)

Neni 1

Përcaktimi i *Palëve*

*Palët* në këtë Marrëveshje janë:

1. Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH), me adresë në Tiranë, sheshi *Fan Noli*, 1001, e përfaqësuar nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar;
2. Universiteti i Sporteve i Tiranës (UST), me adresë në Tiranë, rruga *Muhamet Gjollësja*, 1001, i përfaqësuar nga prof. dr. Agron Kasa, Rektor.

Neni 2

Qëllimi

Kjo Marrëveshje ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit ndërinstitucional midis *Palëve*, si dhe midis strukturave përbërëse të tyre (seksione, komisione, njësi, këshilla e borde; fakultete, institute, njësi kërkimore dhe senate); përcaktimin e *prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe mënyrën e zbatimit të tyre*, mbështetur në legjislacionin në fuqi, në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkëta.



### Neni 3 Parime bazë

Parime themelore rregulluese për bashkëpunimin e *Palëve* janë *liria akademike* dhe *autonomia universitare*. *Palët* bashkëpunojnë duke respektuar njëra-tjetrën në *vetëveprimin e tyre të rregulluar me ligje dhe me akte nënligjore*, përmes nismash, projektsh dhe veprimtarish të përbashkëta akademike e universitare.

Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre *Palët* respektojnë (garantojnë) zbatimin e *Kodit europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj çdo forme të manipulimit në kërkim e konkurrim; ndaj plagjiaturës dhe deformimit të garës.

*Palët* bashkohen në vlerësimin e lartë për *rëndësinë e frymës së olimpizmit*; të konkurrencës dhe *promovimit të energjisë njerëzore*, që çon në *thyerjen progresive të rekordeve dhe të kufijve të mundësive të dëshmuara të zhvillimit fizik dhe intelektual të njeriut si qenie vetjake e kombëtare*.

*Palët* çmojnë se respektimi i *deontologjisë në veprimtarinë sportive* është e *vetnja formë e ligjshme e promovimit të identitetit fizik vetjak dhe kombëtar* në kompeticionet brenda dhe jashtë vendit.

*Palët* çmojnë se suksesi në kërkimin shkencor dhe në konkurrencën sportive bazohet në *synimin për të arritur një shkallë cilësore më të lartë në veprimtarinë mendore dhe fizike, në frymën e skuadrës dhe në respektin për identitetin dhe qenësinë kombëtare*.

### Neni 4 Drejtimit kryesore të bashkëpunimit

Bashkëpunimi midis *Palëve* shtrihet në gjithë fushat e dijes dhe shkencës që kanë objekt dhe interes të përbashkët kërkimor.

*Palët* bashkëpunojnë me përparësi në shkencat e jetës dhe të formimit fizik; të promovimit të dijeve që janë në shërbim të *shëndetit, të lëvizjes, të rekreacionit dhe të rehabilitimit sportiv e shëndetësor*.

*Palët* bashkëpunojnë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta garuese në këto fusha, si dhe për organizimin e konferencave, forumeve, punëtorive, simpoziume etj. Ky bashkëpunim përfshin nxitjen dhe asistimin e *etnosporteve dhe lojërave sportive tradicionale* etj.



*Palët bashkëpunojnë për kryerjen e studimeve të përbashkëta, si dhe për aplikimin dhe për zbatimin e projekteve të përbashkëta shkencore.*

*Palët bashkëpunojnë për nxitjen dhe promovimin e brezave të rinj në shkencë e sporte me kërkesa të larta për individualitet e ambicie për progres.*

*Palët bashkëpunojnë për përsosjen e programeve universitare në shkencat e sportit. Ato inkurajojnë kërkimet ndërdisiplinare dhe ndërthurjen e shkencave të shëndetit intelektual me ato të shëndetit fizik dhe sigurojnë praninë e ekspertëve në formimin e kërkuesve të rinj në ciklin e doktoratës dhe të postdoktoratës. ASHSH dhe Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit nxiten për bashkëpunim të drejtpërdrejtë.*

*Në respekt të legjislacionit në fuqi dhe të traditave të bashkëpunimit, Palët premtojnë nxitjen e përfaqësimit të njëra-tjetrës në organizma që kanë të bëjnë me prestigjin kombëtar e shtetëror (komitete olimpike kombëtare, federata sportive kombëtare); si dhe në organizmat që funksionojnë pranë Akademisë së Shkencave me të njëjtin synim.*

#### Neni 5

#### Bashkëpunime të veçanta

*Përfaqësues të trupës akademike të UST propozohen dhe përfshihen sipas fushave në komisionet e përhershme që funksionojnë pranë ASHSH, veçmas në shkencat e jetës, shëndetit, gjuhësisë dhe identitetit.*

*ASHSH garanton përfshirjen e ekspertëve të UST në nismat shkencore madhore si Enciklopedia shqiptare, Historia e shqiptarëve etj. UST rekomandon e propozon përfshirjen e ekspertëve më cilësorë në këtë proces bashkëpunimi nga radhët e profesoratit të saj.*

*ASHSH dhe UST ftojnë përfaqësues të njëra-tjetrës të marrin pjesë si anëtarë jurie, vlerësues të jashtëm, recensues dhe oponentë në organizimin dhe zhvillimin e konkurseve shkencore e sportive.*

*Përfaqësues të UST ftohen të marrin pjesë në këshillin e botimeve akademike ose si bashkëpunëtorë të tij. ASHSH fton në mbledhjet vjetore të Asamblesë së saj përfaqësues të UST.*



## Neni 6

### Shkëmbimi i botimeve dhe i informacionit

*Palët* i sigurojnë njëra-tjetrës shkëmbimin e ndërsjellë dhe të pakushtëzuar të informacionit shkencor, të periodikëve që botojnë, të studimeve dhe monografive. ASHSH u dhuron periodikisht koleksione të botimeve të saj bibliotekave të UST.

*Palët* shkëmbejnë *ekspertiza dhe mbikëqyrje* të përbashkëta të veprimtarisë shkencore në ekspedita dhe në kërkime dhe të zbatimit të deontologjive specifike që zbatohen në veprimtaritë e secilës prej tyre.

*Palët* informojnë rregullisht njëra-tjetrën për marrëveshjet dy ose shumëpalëshe me interes të ndërsjellë.

## Neni 7

### Zbatimi dhe kohëzgjatja

*Kjo Marrëveshje ka fuqi veprimi me kohë të papërcaktuar.*

*Palët* takohen dy herë në vit për të vlerësuar ecurinë e Marrëveshjes.

Ndërprerja e saj pranohet prej *Palëve* në rastet kur:

- Ndryshon *statusi ligjor i institucioneve* dhe ky ndryshim *prek funksionet themelore* të tyre, me efekt në *Palën* tjetër;

- Njëra nga *Palët* shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazë të saj në procesin e plotësimit të kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 8

### Protokollet e bashkëpunimit

Me vullnetin e *Palëve* kësaj Marrëveshjeje i bashkëlidhen protokolle bashkëpunimi me afate realizimi që përcaktohen me diskutim mes tyre. Protokolle mund të nënshkruhen dhe për një veprimtari të vetme.

## Neni 9

### Ankesat

*Kjo Marrëveshje është çështje dypalëshe.* Për paqartësitë dhe ankesat e



mundshme *Palët* nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër.  
Mosmarrëveshjet midis *Palëve* zgjidhen me bisedime.

Në rast të mosarritjes së dakordësisë për një periudhë dyvjeçare për  
çështje të diskutueshme, kjo Marrëveshje e humbet fuqinë.

Neni 10  
Të fundme

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në dy kopje, të dyja në gjuhën shqipe,  
një për secilën *Palë*, me vlerë të barabartë.

Për:

Universitetin e Sporteve të  
Tiranës

Prof. dr. Agron Kasa, Rektor



Nr. prot. 510  
14.04.2021

Akademinë e Shkencave të Shqipërisë

Akad. Skënder Çjinushi, Kryetar



Tiranë, më 14.04.2021

Nr. prot. 180/3